E enjte, 21 nëntor 2024
[Seancë e hapur]
[Të akuzuarit paraqitet përmes videolidhjes]
--- Seanca fillon në orën 09.01

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Ju kërkoj ndjesë për vonesën. S'po rregulloja dot ndëgjueset.

Vërej që të gjithë të akuzuarit sot na ndjekim përmes videolidhjes, për këtë kanë marrë lejen përkatëse.

Përpara se të fillojmë, Trupi Gjykues merr parasysh kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për riklasifikimin e parashtrimit të protokolluar F02718 për ta riklasifikuar si publik. Përpara se të vendosim lidhur me riklasifikimin, Trupi Gjykues kërkon të marrë parashtrime nga palët lidhur me këtë.

Prokuroria ka diçka për të thënë?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Duhet të kontaktoj eprorët e mi dhe do t'ju them më vonë nëse kam ndonjë kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë prej palëve të tjera ka ndonjë kundërshtim?

Prej Mbrojtjes ka ndonjë kundërshtim?

Në rregull. Do presim atëherë deri sa të bëjmë pushimin dhe të marrim vendimin përkatës.

I lutem Asistentes së Gjykatës të sjellë dëshmitarin në ambientet ku ndodhet.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Për procesverbal, në ambientin ku ndodhemi përmes videolidhjes është Dëshmitari W04393 edhe unë, Sekretarja e seancës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mirëmëngjes, Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjesi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e seancës që është bashkë me ju do t'ju japë betimin solemn të cilin ju duhet ta lexoni me zë të lartë, është betimi solemn. Ju lutem shiheni dokumentin dhe lexojeni me zë.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Betim solemn sipas rregullës 141: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04393

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Tani mund të uleni.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] S’ka përse. Faleminderit juve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që do të zgjasë më pak se një ditë.

Në fillim i bën pyetjet Prokurori. Më pas, mund t’ju bëjnë pyetje Ekipet e Mbrojtjes, por edhe Gjykatësit e Trupit Gjykues mund të kenë pyetje për ju.

Prokuroria ka kërkuar një orë për t’ju bërë pyetje. Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar rreth një orë e 45 minuta. Inkurajoj palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës kur të bëjnë pyetjet. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen kushtet përkatëse.

Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni që ta sqarojmë. Gjithashtu mos harroni të na thoni ku i bazoni ju faktet, rrethanat për të cilat do t’ju bëjnë pyetje.

Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të konfirmoni korrigjimet që ju keni bërë deklaratave tuaja të mëparshme, duhet të thoni me zë për procesverbal që deklaratat, bashkë me korrigjimet përkatëse, pasqyrojnë saktësisht dëshminë tuaj.

Flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për

përkthyesit.

Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë Gjykatës. Nëse dikush jashtë Gjykatës ju bën pyetje për dëshminë tuaj, na informoni menjëherë.

Në qoftë se unë them të mos flisni më, ndërpriteni fjalën ju lutem dhe gjithashtu ndërprisni fjalën nëse më shihni që unë ngre dorën. Sepse kjo do të thotë që unë duhet të jap një udhëzim.

Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na e thoni dhe do ta bëjmë të mundur.

Do të fillojmë tani me pyetjet e Prokurorisë. Dëgjojini me vëmendje.

z. Prokuror, fjala është për ju.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga z. Michalczuk:

Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Ne jemi takuar dhe më përpara po unë dua të prezantohem sërish. Unë quhem Cezary Michalczuk dhe unë do t'i bëj pyetjet sot në emër të Prokurorisë.

Përpara se të fillojmë duam të mësojmë identitetin tuaj.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po për këtë duhet të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, siç ua shpjegova gjatë seancës përgatitore që bëmë bashkë, unë nuk do t'ju bëj pyetje për çdo aspekt të mundshëm, por mund të pranohen si prova gjyqësore deklaratat e mëparshme. Për ta bërë këtë duhet të ndjekim disa hapa proceduralë.

Dëshmitar, a jeni intervistuar më herët nga ZPS-ja, nga

Prokuroria këtu?

PË. Po.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës të nxjerrë në ekran dokumentin, në anglisht dhe në shqip, 061010-TR-ET Pjesa 1 RED2, faqja 1. Në të njëjtin numër është edhe shqipja, po ashtu na nevojitet faqja numër 1.

PY. [REDAKTUAR], i shihni dokumentet në ekran?

PË. Po.

PY. A janë këto dokumentet që keni përpara deklaratat që keni dhënë për ZPS-në, për Prokurorinë?

PË. Po.

PY. Faleminderit.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i heqim tani nga ekrani. Tani, ju lutem, vendosni në ekran dokumentin, anglisht dhe shqip, sërish përbri njëra-tjetrës me numër SPOE00128346-00128385 RED2, faqja 1.

Ky është vetëm një dokument në fakt, po mjafton dhe kështu. Një nga këto dokumente, në fakt, një prej këtyre dokumenteve do ta shohim në faqen 19 sepse është shqipja.

PY. Dëshmitar, a e shihni dokumentin që keni përpara?

PË. Po.

PY. A është një deklaratë e juaj kjo?

PË. Po.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shkojmë në faqen 40, ju lutem.

PY. Dëshmitar, në të majtë është faqja e fundit e këtij

dokumenti. A e shihni nënshkrimin tuaj në këtë dokument, a është i juaji?
PË. Është i imi.
PY. Faleminderit.
Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
PY. Kur u përgatitët për dëshminë sot, a t’u dha mundësia t’i rishikoje dhe një herë këto deklarata?
PË. Po.
PY. Gjatë seancës përgatitore a bëre disa korrigjime dhe disa sqarime të këtyre deklaratave?
PË. Po.
PY. Këto ndryshimet më pas a u hodhën në një shënim të cilin më pas ta lexuam sërish?
PË. Fakt. Po.
PY. A konfirmoni që ajo që ju lexuan ne, pra, ai shënimi kishte pasqyruar saktësisht dhe tërësisht ndryshimet që bëtë ju?
PË. Me përgjegjësi konfirmoj që po.
PY. Tani duke marrë parasysh dhe ndryshimet që kishte ai shënimi, deklaratat a pasqyrojnë saktësisht atë që keni thënë në të shkuarën por që do të thoshit sërish sot në sallën e gjyqit?
PË. Absolutisht po.
Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi

përmbushëm kriteret e rregullës 154, dhe në përputhje me vendimin tuaj që mban numrin F02720 të 14 nëntorit 2024, paragrafi 48 dhe 96(c), ZPS-ja kërkon pranimin e materialeve në shqip dhe në anglisht, përkatësisht me numrat 061010-TR-ET, pjesët 1 deri në 4 RED2 edhe Pjesa 5 e të njëjtit material RED2. Edhe gjithashtu materialin SPOE00128346-00128385 RED2, faqet 1 deri në 18, për anglishten edhe gjithashtu shqipen. Edhe kërkojmë edhe pranimin e provave materiale shoqëruese të evidentuara në paragrafin 47 të vendimit F02720, bashkë me Shënimin Përgatitor numër 1, që ka ERN 123430-123437 të 3 nëntorit 2024.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Materiali që mban numrin 01010-TR-ET, Pjesët 1 deri në 4 RED2 dhe Pjesa 5 pranohen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, kjo deklaratë është e ndarë në pesë pjesë.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, thashë edhe Pjesa 5, vetëm se Pjesa 5 ka pasur një rishikim të dytë. Po pesë pjesë janë.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Pjesa 1, Pjesa 1 e materialit 061010 do të marrë numrin e provës

P018646.1. Pjesa 2 do të marri numrin P01846.2. Pjesa 3 do të marri numrin P01846.3. Pjesa 4 do të marrë numrin P01846.4. Dhe Pjesa 5 do të marrë numrin P01846.5. Klasifikimi është konfidencial për të pesta pjesët.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Materiali SPOE00128346 deri në 00128385 RED2, faqet 1 deri në 18 vetëm?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nga faqja 1 deri në faqen 18, është anglishtja. Por në të njëjtin dokument nga faqja 18 deri në faqen 40, është përkthimi në gjuhën shqipe.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, kërkoni faqen 1 deri në 18 bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Pranohen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata do të marrë numrin P01847. Klasifikimi është konfidencial.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Provat materiale shoqëruese pranohen dhe gjithashtu pranohet dhe Shënimi Përgatitor me numër 123430 deri në 123437.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor do të marrë numrin P01848. Klasifikimi është konfidencial.

Dhe prova e parë shoqëruese do të marrë numrin SPOE00130484-00130485, marrin numrin P01849. Klasifikimi është konfidencial.

Prova e dytë shoqëruese me ERN U008-2500 deri në U008-2535 RED2. Kjo është vetëm një faqe?

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm faqja 29.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë faqja 29 që mban numrin U008-2528 deri në U008-2528 dhe përkthimi përkues në gjuhën angleze do të marri numrin e provës materiale P01850. Dhe klasifikimi është konfidencial.

Dhe prova e fundit shoqëruese me ERN 061009-061009 dhe përkthimi në anglishte do të marri numrin e provës P01851. Dhe klasifikimi është konfidencial.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, do të doja të lexoja një përmbledhje të shkurtër të dëshmisë së këtij dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në 1998, Dëshmitari me numër W04393 u rrëmbye nga tre persona të armatosur dhe me maska që mbanin uniforma të zeza të UÇK-së dhe emblemën e UÇK-së, ku e çuan në një vend të UÇK-së dhe e mbajtën të ndaluar për disa ditë. Atje i kanë bërë pyetje anëtarët e UÇK-së dhe është keqtrajtuar në mënyrë të përsëritur.

Tani kam disa pyetje për këtë dëshmitar dhe për këtë do të doja të kalonim në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të

kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë minuta pushim.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.03

--- Seanca rifillon në orën 10.15

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Përpara se të kalojmë në seancë private, do të doja t'ju thoja diçka lidhur me çështjen që

lamë të papërfunduar pak më herët për parashtrimin e protokolluar. E kam fjalën që nuk kemi kundërshtime për klasifikimin e dokumentit F02718, të cilin e diskutuam kur filluam ditën e sotme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do të jap urdhrin me gojë atëherë.

Në kuadër të parashtrimeve që kanë bërë palët dhe pjesëmarrësit dhe meqenëse nuk pati asnjë kundërshtim, Trupi Gjykues miraton kërkesën e paraqitur në parashtrimin e protokolluar F02278 [Sipas përkthimit], dhe urdhëron Zyrën Administrative të riklasifikojë kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes dhe të marrë masat përkatëse për të garantuar seanca të paanshme dhe transparente të cilat nuk cenojnë ekipet e Mbrojtjes. Ky është parashtrimi i protokolluar F02718. Dhe ky dokument riklasifikohet si publik.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë pushim deri në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.04

--- Seanca rifillon në orën 11.31

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka diçka për të thënë.

Z. TULLY: [Përkthim] Shumë shkurt. Dje morëm shënimet përgatitore për javën e ardhshme. Faleminderit për këtë. sikurse e kuptohet janë goxha voluminoze rreth 30 faqe. A është e mundur që Prokuroria të na japi dhe materialet që do të përdori përpara fundjavës, ju lutem, në mënyrë që të përgatitemi dhe ne siç duhet për javën e ardhshme.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do pyes dhe do ju njoftoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Komunikoni me

njëri-tjetrin drejtpërsëdrejti.

Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do komunikojmë me njëri-tjetrin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Meqë s’ka më pyetje, komente, e mbyllim për sot dhe shihemi të hënën në orën 9.00.

--- Seanca mbyllet në orën 11.43